

Shkurt 2026

OZAL PRES

ZËRI I TURGUT OZAL JE TI


Aktivitetet

Sukseset

Zëri i Nxënësve

DILJON DURIÇI
ERKA REÇI

Rubrikat



Aktualiteti në shkollën Turgut Özal

Këndi i të qeshurës

Yjet në fokus

Këndi i kulturës

Këndi kreativ

Top picks

Këndi sportiv

Rubrika e muajit



AKTUALITETI

ne Turoqut Ozal



Profession Fair

Nga Zyra e Këshillimit u organizua “Profession Fair”, një aktivitet i fokusuar në planin e biznesit dhe profesionet e ardhshme të nxënësve. Morën pjesë shumë nxënës duke shfaqur ide kreative dhe ambicie për të ardhmen e tyre profesionale. Le të themi se u njohëm me doktorët, arkitektët, inxhinierët, avokatët e së ardhmes dhe jo vetëm.



Mock Interviews

Zyra e Këshillimit organizoi gjithashtu “Mock Interviews”, një simulim interviste për pranim në universitet ose në punë. Aktiviteti pati shumë kërkesa dhe nxënësit patën mundësi të përjetojnë një përvojë reale intervistimi.

Urojmë që secili prej tyre të ketë dalë sa më mirë dhe të kenë dhënë maksimumin e tyre!

Escape Room

Nxënëset e klasës 11B, Elisa Nezha, Elitsa Radeva, Fjona Lleshi dhe Klesta Gançi organizuan një “Escape Room”, i cili ndërthuri shkathtësine me njohuritë matematikore. Sfidat ishin interaktive, kreative dhe argëtuese. Ky aktivitet nxiti bashkëpunimin, logjikën dhe mendimin kritik mes nxënësve, por edhe i stimuloi ata në një mënyrë më ndryshe nga ç’jemi mesuar.

ASEF

Më 15 shkurt u zhvillua ASEF (Albanian science and engineering fair), konkursi kombëtar që mbledh çdo vit nxënës nga shkolla të ndryshme për të prezantuar projektet e tyre shkencore dhe inxhinierike. Në kategorinë e Shkencave Natyrore, pjesëmarrësit prezantuan projekte duke paraqitur modele 3D, eksperimente dhe ide inovative përpara jurisë, të cilët vlerësuan nxënësit.



MUN

Miratimi i projektligjeve në Kuvend.

Një grup nxënësish nga shkolla jonë zhvilluan një aktivitet, në të cilin ata morën rolin e deputetëve dhe u përfshinë në procesin e debatit dhe votimit të projektligjeve.

Gjatë aktivitetit, ata prezantuan idetë e tyre, diskutuan mbi propozimet dhe simuluan funksionimin e një seance parlamentare. Në përfundim të debatit dhe votimit, të dy projektligjet e paraqitura u miratuan.

KONKURSI I SHKENCES



Në kuadër të Javës së Shkencës në shkollën tonë u zhvillua konkursi i njohurive “Java e Shkencës”. Aktiviteti u realizua në platformën Quizizz, ku çdo klasë konkurroi me nxënës përfaqësues, duke punuar në grup dhe duke testuar njohuritë e tyre. Nga secili vit u shpall një klasë fituese, duke përmendur: nga viti i parë 10C dhe 10F, dhe nga viti i dytë 11G për të dytën herë radhazi.

Përgëzime të gjithë nxënësve pjesëmarrës për angazhimin dhe performancën e tyre!

KONKURSI BALLKANIK I EKSPERIMENTEVE

Në muajin shkurt u zhvilluan olimpiadat balkanike për lëndët shkencore.

Ekipet e zgjedhura nga mësuesit na përfaqësuan me dinjitet në fazën e parë në Durrës dhe në të dytën në Maqedoni. Ata erdhën me fitore të shumta dhe eksperiencë të reja!

Ja dhe fituesit:

Vendi i parë në Kimi: Agvesa Sakajani, Leyla Sena Aksel, Luis Shella

Vendi i parë në Fizikë: Ambra Dardha, Endri Çelçima, Erind Çelçima, Ledjon Nezha

Vendi i dytë në Biologji: Arenc Subashi, Dalin Goga, Ester Jaçaj, Kevin Kaçani
Pikërisht me këta nxënës ne kemi realizuar intervista, për të na shpjeguar eksperiencën e tyre. Intervistat mund t'i shihni në instagramim e shkollës.





**Nga gazetarja:
Herika Oruçi**



YJET NË FOKUS

ANILA HOXHA

KEMI PASUR KËNAQËSINË TË
INTERVISTOJMË GAZETAREN E NJOHUR
INVESTIGATIVE, ANILA HOXHA, PËR
RUBRIKËN TONË "YJET NË FOKUS". NË KËTË
INTERVISTË, AJO NDAN PËRVOJAT E SAJ,
SFIDAT DHE MOMENTET MË INTERESANTE
NGA KARRIERA E SAJ NË GAZETARI.
INTERVISTËN E PLOTË MUND TA LEXONI NË
FAQEN TJETËR TË GAZETËS.



Gazetarja: Mirë se erdhët, znj. Anila Hoxha! Faleminderit që pranuat ftesën tonë. Si fillim, do të doja t'ju pyesja pse zgjodhët profesionin e gazetarisë dhe cili ka qenë momenti juaj i preferuar në këtë profesion?

A. Hoxha: Gazetarinë e kam dashur shumë gjithmonë dhe nuk ka ndonjë arsye tjetër përveç faktit që e kam dashur dhe e dua. Kjo është.

Pse hyra në aktualitet dhe në kronikën e zezë? Kam pasur një emision në radio për çështjet e krimit dhe të drejtësisë. Shkak u bë vrasja e një shoqeje të shkollës së lartë, që quhej Kozeta Hyseni, vajza e një ish-prokurori. Ai sapo kishte nisur të hetonte një çështje të trafikut të paligjshëm të skrapit në Durrës, ndërsa vajza e tij u vra në Tiranë.

Në atë moment e lashë emisionin në radio dhe kalova si gazetare e kronikës së zezë, ku vazhdoj edhe sot të raportoj për çështje të drejtësisë. Në total janë 27 vite, të cilat i mbush në prill të këtij viti.

Gazetarja: Cili ka qenë një nga rastet më të vështira gjatë profesionit tuaj?

A. Hoxha: Ka pasur shumë momente të vështira, që nuk do t'i lidh me kërcënimet apo mbylljen e dyerve. Më shumë kanë qenë momente të vështira për të vendosur se si të trajtoja një histori të caktuar.

Për shembull, rasti i raportimit të disa fëmijëve të braktisur në Bardhushk. Nëna e tyre kishte vrarë bashkëshortin dhe u arrestua. Ajo quhej Aishe Pujana. Fëmijët e saj u harruan nga shteti mes dy maleve, në një zonë malore të Bardhushkut. U harruan edhe nga familjarët e gruas së akuzuar për vrasje dhe nga familjarët e viktimës. Të dyja palët i quanin "fëmijët e vrasëses" ose "fëmijët e burrit që na shkatërroi familjen".

Ai ishte një moment shumë i vështirë, sepse kur i gjeta fëmijët vetëm në atë zonë malore, më duhej të vendosja nëse do t'i intervistoja apo jo. Duhej të vendosja kufirin mes informimit dhe shfrytëzimit për sensacion. Ata kishin nevojë për ndihmë, që institucionet të reagonin dhe publiku të informohej.

Në fund vendosa t'i intervistoja dhe pati një reagim shumë të madh nga shoqëria shqiptare. U tregua qartë se si disa fëmijë të mitur, motra e vëllezër, kishin mbetur në një situatë mbijetese, të braktisur nga të gjithë dhe nga shteti. Më pas pati reagime nga qytetarë që kërkuan t'i adoptonin dhe edhe institucionet, megjithëse me vonesë, morën përgjegjësi për ta.

Kam pasur edhe raste të tjera të vështira. Për shembull, një person nga burgu më shkruante vazhdimisht se ishte i pafajshëm. Në fillim nuk i kushtova shumë rëndësi, sepse marr shumë letra të tilla. Por këmbëngulja e tij më vuri përballë një dileme profesionale: a po thoshte të vërtetën apo jo?

Vendosa ta intervistoja dhe ta ndiqja rastin në gjykatë. Ai pretendonte se gjithçka kishte nisur gjatë periudhës së COVID-it. Kishte shkelur urdhrat e karantinës dhe policia e kishte ndjekur. Më pas iu vendosën disa masa sigurie njëra pas tjetrës: për shkelje të karantinës, për kundërshtim policie dhe për shkelje të masës së arrestit në shtëpi.

Pas raportimit tim, pati verifikime nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë dhe nga institucionet përkatëse mbi trajtimin e qytetarit. Edhe ky ishte një moment i vështirë profesionalisht.

Gazetarja: Faleminderit. Pyetja e fundit: çfarë do t'ju thonit nxënësve që duan të ndjekin gazetarinë në të ardhmen?

A. Hoxha: Do t'i thosha kujtdo që ka një ëndërr ta ndjekë atë. Nëse ëndrra juaj është gazetaria, ndiqeni, sepse është një profesion shumë i bukur.

Gazetarja: Shumë faleminderit që pranuat ftesën.

A. Hoxha: Faleminderit.

KËNDI I KULTURËS



Grammy Awards janë çmime prestigjioze të muzikës që jepen çdo vit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga Recording Academy. Ato vlerësojnë artistët për arritjet më të mira në muzikë (pop, rap, rock, latin, etj.). Grammy konsiderohen ndër çmimet më të rëndësishme në industrinë muzikore.

Disa nga fituesit më të spikatur sipas kategorive

- Best Pop Vocal Album: Lady Gaga – Mayhem
- Best Pop Solo Performance: Lola Young – Messy
- Best Dance/Electronic Album: FKA twigs – Eusexua
- Best Rock Album & Metal Performance: Turnstile – Never Enough / Birds
- Best African Music Performance: Tyla – Push 2 Start
- Best Global Music Performance: Bad Bunny – EoO
- (Ka edhe fitues të tjerë në shumë kategori më tepër në total shpërndahen 95 çmime çdo vit.)

Fituesit kryesorë të Grammy 2026

🎵 “Big 4”

- Album of the Year: Bad Bunny – *Debí Tirar Más Fotos* (albumi i vitit)
- Record of the Year: “Luther” – Kendrick Lamar & SZA
- Song of the Year: “Wildflower” – Billie Eilish
- Best New Artist: Olivia Dean



Bad Bunny

Ai fitoi Album of the Year në Grammy Awards 2026 dhe çmime të tjera si Best Música Urbana Album.

Ai gjithashtu performoi në një ndeshje të NFL me një show shumë energjik.






KOMPETICIONI I ARTIT TË RICIKLUESHËM



Gjithmonë ka një mundësi për ndryshim, prandaj edhe këtë muaj organizimet kreative janë pjesë e pandashme e jetës sonë shkollore. Këtë muaj, këndi ynë merr një pamje “green-ish”, që tërheq vëmendjen tek rëndësia e mjedisit dhe kujdesi për natyrën, duke e lidhur kreativitetin me ndërgjegjësimin ambiental. Ky kombinim i ngjyrave, ideve dhe aktiviteteve na fton të mendojmë për ndryshimin që mund të sjellim vetë, si brenda shkollës ashtu edhe në komunitetin tonë më të gjerë.

KËNDI KREATIV



“Use it up, wear it out, make it do, or do without.”

Më shumë mbi riciklimin...

Riciklimi në shkolla ndihmon në edukimin e nxënësve që në moshën e gjimnazit, duke forcuar ndërgjegjësimin për përgjegjësinë tonë si qytetarë dhe pjesë e komunitetit.

Me bindjen se ndryshimi nis nga vetja dhe udhëhequr nga pasioni për artin, nxënësit e shkollës sonë shpalosën kreativitetin e tyre duke u bërë pjesë e kompeticionit inovativ të propozuar nga klubi shkollor “Make a Change”. Kjo ishte një mundësi unike për të materializuar imagjinatën e tyre: nga përdorimi i tapave plastike e deri te shishet e ricikluara, ata dëshmuuan se asgjë nuk është thjesht një “mbeturinë”, por një formë ndryshe e të bërit art.




TOP PICKS



Aplikacioni i vitit: TikTok

Gjatë Shkurtit, TikTok është plot me video romantike, dedikime dhe “couple edits”. Është aplikacioni ku nxënësit ndajnë ndjenja, surpriza dhe momente speciale për Shën Valentin.



Kënga e Muajit: “CHIIHIRO” – Billie Eilish



“CHIIHIRO” sjell një atmosferë misterioze dhe emocionale, perfekte për muajin e dashurisë. Me tinguj modernë dhe tekst që flet për ndjenja të thella dhe lidhje që lënë gjurmë, kjo këngë është zgjedhje ideale për ata që e ndjejnë Valentinin pak më ndryshe – më të thellë, më intensiv.



KENDI SPORTIV



**EMOCIONE, GARË
DHE FRYMË!**



KAMPIONATI MBYLLET ME SUKSES: JA CILËT ISHIN FITUESIT

Me përfundimin e Kampionatit të Futbollit në shkollën tonë, u mbyll me sukses një nga aktivitetet më të shumëpritura të vitit shkollor, i cili solli emocione, energji dhe frymë të fortë gare mes nxënësve. Gjatë zhvillimit të tij, ndeshjet u shoqëruan me mbështetje dhe entuziazëm nga të gjithë, duke forcuar bashkëpunimin dhe respektin mes klasave. Pas një serie përballjesh konkurruese, fituese u shpall klasa 11C, e cila u dalluan për organizimin, lojën e disiplinuar dhe performancën e saj të shkëlqyer në fushë, duke merituar plotësisht vendin e parë.

Organizatori i kampionatit, profesori i edukimit fizik, Roxhersi, ka qenë një nga personat kryesorë në realizimin e këtij aktiviteti sportiv në Kolegjin “Turgut Ozal”. Ai ka kontribuar në organizimin dhe mbarëvajtjen e kampionatit, duke theksuar rëndësinë që ka sporti për bashkëpunimin, disiplinën dhe frymën e ekipit mes nxënësve.

”

“Sporti nuk ndërton karakterin; ai e zbulon atë.” – Heywood Broun





Mes Nesh



Pse Shkurti quhet Muaji i dashurisë?

Shkurti lidhet me festën e Shën Valentinit, e cila festohet në shumë vende si simbol i dashurisë dhe miqësisë. Por në shkollën tonë, ne e shohim shkurтин jo vetëm si muajin e të dashuruarve, por si muajin e kujdesit për shokët, respektit dhe mirësisë së përditshme. Sepse miqësitë më të bukura shpesh fillojnë... në bankat e shkollës :]



Kartolina Mirësie



"Ma bën ditën
më të bukur."

"Më pëlqen si arrin
gjithmonë të qeshësh
edhe kur gjërat nuk
shkojnë si duhet."

"Je shembull për
mua"

"Faleminderit që
je gjithmonë aty
kur kam nevojë"

"Je një person i
veçantë për mua."

"Je një nga personat
më pozitivë që kam
njohur"

"Mos harro të
buzëqeshësh sot"

Ky muaj na kujton se dashuria nuk është vetëm një ditë, por një gjest i vogël çdo ditë. Një buzëqeshje në korridor, një ndihmë në detyra, një falenderim i singertë, këto janë gjërat që e bëjnë shkollën tonë një familje.



KËNDI

i të qeshurës

NË MES TË LIBRAVE, DETYRAVE DHE PROVIMEVE, “KËNDI I TË QESHURËS” SJELL PAK DRITË
DHE SHUMË BUZËQESHJE NË TURGUT OZAL COLLEGE.

SEPSE SHKOLLA NUK ËSHTË VETËM MËSIM, POR EDHE MOMENTE QË NA BËJNË TË QESHIM
BASHKË.

GJËEQJËZA



1. JAM GJITHMONË NË KLASË, POR ASKUSH S'MË SHEH. KUR BIE ZILJA, ZHDUKEM.
ÇFARË JAM?

2. SA MË SHUMË MË PËRDOR, AQ MË E VOGËL BËHEM. ÇFARË JAM?


3. KAM FAQE, POR S'JAM NJERI. MË HAP ÇDO DITË NË SHKOLLË. ÇFARË JAM?

4. NUK KAM ZEMËR, POR PËR SHËN VALENTIN MË BLEJNË SHUMË. ÇFARË JAM?

PLOTËSO FJALINË:

- “NËSE DO TË JEPJA NJË TRËNDAFIL, DO IA JEPJA _____ SEPSE _____.”
- “PERSONI QË GJITHMONË MË BËN TË QESH NË KLASË ËSHTË _____.”
- “NËSE DO TË EKZISTONTE ‘ÇMIMI I BUZËQESHJES MË TË BUKUR’, DO E FITONTE _____.”






FALEMINDERIT

Në nder të stafit tonë

Sonila Shehu
Rajmonda Haxhijaj
Diljon Duriçi-11G
Erka Reçi-11G
Anda Çeka-11G
Orjon Baka-11G
Ester Hysa-11G
Bora Cana-11G
Herika Oruçi-11G
Erjona Kovaçi-11G
Kamil Shehu-11F
Bjorn Koçi-11F
Jasemina Ahmati-12A



KËTU DO TË GJENI KANALIN E YOUTUBE-IT TONË
https://www.youtube.com/@turgutozal_highschooltirana

KËTU DO TE GJENI WEBSITE-TIN TONË
<https://highschool.turgutozal.edu.al>

